

VENDIM
Nr. 103, datë 24.2.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 1/3, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e institucionit dhe të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama